Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0986

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amandamentuar me datën 09. 08. 2023 në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE "Alboss" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-11993-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit, më 26/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Alboss" SH.P.K. me nr. 2023/0986, e datës 06/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit", me numër të prokurimit 622-23-11993-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit.

2. Vërtetohet, vendimi i Autoriteti Kontraktues (AK) për anulim të aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit", me numër të prokurimit 622-23-11993-5-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 31.10.2023, Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit", me numër të prokurimit 622-23-11993-5-2-1.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 270,000.00 €.

Me 24. 11. 2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me 29.11.2023, OE "Alboss" SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi anulim të kontratës, të cilën AK e ka refuzuar me datën 04. 12. 2023.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues "Alboss" SHPK ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2023/0986 e datës 06.12.2023, për aktivitetin e sipërcituar.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alboss" SHPK janë parashtruar si në vijim:

- Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit. Në bazë të formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues-Komuna e Prizrenit me dt:24.11.2023, anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimi: "nuk kemi asnjë ofertë përgjegjshme". Ndërsa AK sipas B42 letrës standarde për tenderuesin e eliminuar për operatorin ekonomik "Alboss" Sh.p.k", të datës 24.11.2023, ka potencuar tenderi juaj është refuzuar për këto arsye ju mungojnë: 4.OE duhet të posedojë pajisje teknike të nevojshme (një bager min.8 - 10 ton, një bager 1 deri 1.5 ton), min. Një kamion (min.8 ton), min 2 kamion me peshën ngarkuese 2-4ton, min. një luge ngarkuese deri 3.5 ton dhe min. një cilinder deri 3 ton, një damper me peshe bartëse 3-6ton, një damper me peshe bartëse 6-8ton, një kamionët me kiper me peshe bartëse deri 1.5t, gypa për largimin e materialeve inerte, skele min. 1000 m2, një kompresor me tërheqje me regjistrim valid. 4.Një listë të mjeteve apo paisjeve teknike qe janë në dispozicionin tuaj për

te ekzekutuar kontratën në fjalë- paisjet dhe makineria në dispozicion të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me kopje të librezave valide të qarkullimit ndërsa pajisjet tjera duhet të dëshmohen me dëshmi mbi pronësinë e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të dorëzohen në kopje të qarte dhe të lexueshme. Mungojnë ose nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas njoftimit për kontrate dhe dosje te tenderit këto paisje teknike: një damper me peshe bartëse 6-8ton, një kompresor me tërheqje me regjistrim valid. I pa kënaqur me njoftim e AK-së, OE ankues parashtron kërkesë për rishqyrtim me datë: 29.11.2023. Ndërsa AK me datë 04.12.2023, përmes vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim dhe lenë në fuqi njoftimin mbi vendimin për anulim. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 62 dhe 69 të LPP-së. Lidhur me pretendim e OE ankues se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave pas kërkesës së tyre të parë për rishqyrtim, AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së sepse ofertën e tyre se kanë trajtuar drejtë duke e kualifikuar të pa përgjegjshme edhe pse i kemi plotësuar kërkesat formale për kualifikim të DT. Tutje, OE ankues pretendon se AK krijuar rrethana me qellim të diskriminimit të ndërmarrjes së tyre në raport me operatoret tjerë konkurruese dhe kanë eliminuar ofertën e tyre pa asnjë arsye ligjore duke u thirrur në disa pajisje që fare nuk kanë ndikim në realizimin e projektit. OE ankues pretendon se AK gjatë rivlerësimit ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së sepse ka eliminuar e ofertën e tyre si te pa përgjegjshëm në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, me arsyetimin se ju mungojnë: një damper me peshë bartëse 6-8 ton dhe një kompresor me tërheqje me regjistrim valid. OE ankues shtonë se këto pajisje nuk janë pengesë për realizimin e këtij projekti sepse munden lehtë të zëvendësohen me pajisje të përafërta. Devijimet të tilla jo materialë si këto dy pajisje janë të lejuara me nenin 59.4 të LPP-së. AK ka qenë favorizues sepse Damperi mundet të jetë edhe më i vogël se 6 ton por edhe më i madh se 8 ton kryen të njëjtën pune. Po ashtu regjistrimi i kompresorit është tendencioz sepse është pajisje pune e cila mundet të ngarkohet ne kamion dhe të bartet në punishte. Këto dy pika te eliminimit te ofertës se tyre janë formale. Tutje OE shton se AK ka bere shkelje te nenit 69 të LPP-së, sepse kërkesat qe ka paraqite në dosjen e tenderit ne i kemi plotësuar dhe kemi paraqitë raportin për mjete dhe stabilimentet me pajisje teknike të cilat janë të mjaftueshme për realizimin e projektit.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit "Alboss" SHPK

- Me rastin e përgatitjes së Njoftimit për një aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues përgatitë kushte e kualifikimit të cilat janë obligative që të përmbushen nga secili OE i cili don të merr pjesë në një aktivitet të tillë. Paraprakisht bëhet vlerësimi i arsyeshmërisë së vendosjes së kritereve të caktuara, pra secili kriter ka arsyen pse është vendosë si i tillë. Mospërmbushja e njërit nga këto kritere të vendosura e bën OE të papërgjegjshëm. Bazuar në këto më lartë, në procesin e rishqyrtimit të ofertës tuaj kemi hasë në të njëjtat mangësi të cilat i ka konstatuar edhe komisioni i cili më herët ka bërë vlerësimin e ofertave andaj si të tilla mangësi, juve si OE iu bëjmë të papërgjegjshëm.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07.12.2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 986/23 ndërsa me datë 15.12.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*eksperti shqyrtues i propozon*

panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi njoftimi i AK mbi anulimin e aktivitet të prokurimit".

Konstatimet e ekspertes shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 997/23 të operatorit ekonomik "Alboss" SHPK

- *Konstatimi i ekspertes për pretendimet ankimore:*Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK përmes formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues Komuna e Prizrenit me dt:17.11.2023, ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik, i pa kënaqur me ketë njoftim, OE ankues "Alboss" SHPK paraqet kërkesë për rishqyrtim, ndërsa AK përmes vendimit anulon këtë njoftim dhe lëndën e kthen në rivlerësim. Pas ri-vlerësimit të ofertave, përkatësisht me datën 24.11.2023, përmes formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimi: *"nuk kemi asnjë ofertë përgjegjshme"*. Ekspertja shqyrtuese në vijim do jep përgjigje në pretendimet e ankuesit duke i përmbledhur në tërësi pretendimet e ankuesit. AK Komuna e Prizrenit tek kërkesat e Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar: përkatësisht tek pika 4. *OE duhet të posedoje paisje teknike të nevojshme (një bager min.8 - 10 ton, një bager 1 deri 1.5 ton), min. Një kamion (min.8 ton), min 2 kamion me peshën ngarkuese 2-4ton, min. një luge ngarkuese deri 3.5 ton dhe min. një cilindër deri 3 ton, një damper me peshe bartëse 3-6ton, një damper me peshe bartëse 6-8 ton një kamionët me kiper me peshe bartëse deri 1.5t, gypa për largimin e materialeve inerte, skele min. 1000 m2, një kompresor me tërheqje me regjistrim valid.* Dëshmia e kërkuar dokumentare: *Një listë të mjeteve apo paisjeve teknike qe janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontratën në fjalë- paisjet dhe makineria në dispozicion të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me kopje të librezave valide të qarkullimit ndërsa pajisjet tjera duhet të dëshmohen me dëshmi mbi pronësinë e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të dorëzohen në kopje të qarte dhe të lexueshme.*
- Ekspertja shqyrtuese sqaron OE ankues me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull "11-Lista makinerisë ALBOSS, makineria.pdf" por siç e pohon edhe vet ankuesi në ankesë e tij, se nuk ka ofruar pajisjen "*një damper me peshe bartëse 6-8 ton" dhe "kompresor me tërheqje me regjistrim valid",* i njëjti potencon se këto dy pajisje "nuk kanë ndikim në realizimin e projektit" sepse "kemi paraqitë raportin për mjete dhe stabilimentet me pajisje teknike të cilat janë të mjaftueshme për realizimin e projektit", dhe po ashtu sipas tij nuk janë pengesë për realizimin e këtij projekti sepse munden lehtë të zëvendësohen me pajisje të përafërta dhe sipas tije është devijim i lejuar sipas nenit 59.4 të LPP-së.
- Ekspertja shqyrtuese sqaron se operatorët ekonomik të cilët marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit mund të parashtrojnë ankesë pranë AK-së në rast se vlerësojnë që një kërkesë është diskriminuese apo kufizuese ose e pa nevojshme për atë aktivitet të prokurimit neni 108/A par.3.1 i LPP-së. Por në rastet kur OE-të nuk parashtrojnë ankesë në lidhje me kërkesat e vendosura në dosje të tenderit, nënkupton se janë pajtuar më këto kërkesa. Në rastin konkret, AK në mesin e kërkesave, ka kërkuar *një damper me peshe bartëse 6-8 ton dhe "kompresor me tërheqje me regjistrim valid. që do të thotë "paisjet dhe makineria në dispozicion të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me kopje të librezave valide të qarkullimit"*, kurse OE ankues siç u sqarua dhe më lartë nuk ka ofruar këto pajisje sipas kërkesës së AK-së. Andaj, ekspertja shqyrtuese sqaron se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet sipas kërkesave të vendosura në dosje të tenderit lidhur me nenin 59, par. 4 të LPP-së, dispozitë e cila përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në rastin konkret,

AK sipas njoftimit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimi: *"nuk kemi asnjë ofertë përgjegjshme"*. Prandaj në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa vlerësoj që vendimi i AK-së, të mbetet në fuqi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa Operatori ekonomik nuk është deklaruar.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave sipas ankesës së dorëzuar me numër protokolli Nr. 986/23 mori paraprakisht në shikim raportin e ekspertes shqyrtuese në të cilin mes tjerash theksohet se, cituar: "...AK Komuna e Prizrenit tek kërkesat e Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar: përkatësisht tek pika 4.OE duhet të posedoje paisje teknike të nevojshme (një bager min.8 - 10 ton, një bager 1 deri 1.5 ton), min. Një kamion (min.8 ton), min 2 kamion me peshën ngarkuese 2-4ton, min. një luge ngarkuese deri 3.5 ton dhe min. një cilindër deri 3 ton, një damper me peshe bartëse 3-6ton, një damper me peshe bartëse 6-8 ton një kamionët me kiper me peshe bartëse deri 1.5t, gypa për largimin e materialeve inerte, skele min. 1000 m2, një kompresor me tërheqje me regjistrim valid, e cilat duhet të dëshmohet: Një listë të mjeteve apo paisjeve teknike qe janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontratën në fjalë-paisjet dhe makineria në dispozicion të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me kopje të librezave valide të qarkullimit ndërsa pajisjet tjera duhet të dëshmohen me dëshmi mbi pronësinë e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të dorëzohen në kopje të qarte dhe të lexueshme.OE ankues me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull "11-Lista makinerisë Alboss, makineria.pdf" por siç e pohon edhe vet ankuesi në ankesë e tij, se nuk ka ofruar pajisjen "*një damper me peshe bartëse 6-8 ton" dhe "kompresor me tërheqje me regjistrim valid",* i njëjti potencon se këto dy pajisje "nuk kanë ndikim në realizimin e projektit" sepse "kemi paraqitë raportin për mjete dhe stabilimentet me pajisje teknike të cilat janë të mjaftueshme për realizimin e projektit", dhe po ashtu sipas tij nuk janë pengesë për realizimin e këtij projekti sepse munden lehtë të zëvendësohen me pajisje të përafërta dhe sipas tij është devijim i lejuar sipas nenit 59.4 të LPP-së", mbarim citati.

Paneli shqyrtues nisur nga ky fakt i sqaruar nga ekspertja shqyrtuese, vlerëson se operatorët ekonomik të cilët marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit mund të parashtrojnë ankesë pranë AK-së në rast se vlerësojnë që një kërkesë është diskriminuese apo kufizuese ose e pa nevojshme për atë aktivitet të prokurimit neni 108/A par.3.1 i LPP-së. Por në rastet kur OE-të nuk parashtrojnë ankesë në lidhje me kërkesat e vendosura në dosje të tenderit, nënkupton se janë

pajtuar më këto kërkesa. Në rastin konkret, AK në mesin e kërkesave, ka kërkuar *një damper me peshe bartëse 6-8 ton dhe "kompresor me tërheqje me regjistrim valid. që do të thotë "paisjet dhe makineria në dispozicion të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me kopje të librezave valide të qarkullimit"*, kurse OE ankues siç u sqarua dhe më lartë nuk ka ofruar këto pajisje sipas kërkesës së AK-së", andaj pretendimet e OE ankues lidhur me vendimin e AK, për panelin janë të paqëndrueshme pasi që AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar në harmoni të nenit 59 par 4 të LPP dispozitë e cila përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Duke qenë se tenderi i Ankuesit nuk është konform kërkesave, paneli shqyrtues me të drejtë vlerëson se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin: *"nuk kemi asnjë ofertë përgjegjshme".*

Prandaj, bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli konsideron se nuk ka shkelje të dispozitave të cilat janë cituar nga ankuesi, kurse Vendimi i atakuar i AK duhet mbetur në fuqi, sepse pikërisht anulimi i të njëjtit, atakon në ketë rast qëllimet primare të LPP të sanksionuara me nenin 1 dhe parimet e përgjithshme të këtij Ligji të sanksionuara me nenin 6, sipas të cilit "Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës" lidhur me neni 104 të LPP, sipas të cilit "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë".

Në përfundim të gjithë kësaj Paneli vendosi sikurse në dispozitivin e këtij, nisur nga bindja dhe gjykimi i pavarur i tij se ka aplikuar zgjidhje ne duhur në ketë rast. Raporti i ekspertit shqyrtues (i brendshëm apo i jashtëm) ndonëse nuk është detyrues për Panelet Shqyrtuese të cilat në proceset e vendimmarrjes ushtrojnë pavarësinë e plotë në zbatimin e kompetencave sipas nenit 105 të LPP, i njëjti në çdo rast analizohet dhe i njihet vlera provuese në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde. Sido që të jetë, sipas paragrafit 4, të nenit 59, AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, gjë në rastin konkret Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me ketë. Andaj, nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, paneli shqyrtues vlerëson se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në harmoni me nenin 62 të LPP-së, në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

- Përfundim -

Paneli konsideron se secili AK (në nivelin lokal apo qendror) ushtron autonominë ligjore në planifikimin e nevojave dhe përmbushjen e tyre sipas nenit 8 dhe 9 dhe ka të drejtë ta përpiloj dosjen e tenderit sikurse i lejohet kjo në kuptim të nenit 27 të LPP, sipas të cilit "autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes..."

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **"ALBOSS"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: